




# Udhëzuesi i aparatit të dëgjimit jazz XC Pro në vesh (ITE)



 **HANSATON**  
*hearing & emotions*





## Faleminderit

Faleminderit që keni zgjedhur këto aparate dëgjimi.

Ky udhëzues përdorimi vlen për modelet e mëposhtme  
Viti i qarkullimit: 2020

Modelet me valë:

jazz XC Pro 3-312 Dir W

jazz XC Pro 5-312 Dir W

jazz XC Pro 7-312 Dir W

jazz XC Pro 9-312 Dir W

Modelet jo me valë:

jazz XC Pro 3-10

jazz XC Pro 5-10

jazz XC Pro 7-10

jazz XC Pro 9-10

jazz XC Pro 3-312

jazz XC Pro 5-312

jazz XC Pro 7-312

jazz XC Pro 9-312



## Aparatet tuaja të dëgjimit

Kujdesi i të dëgjuarit profesional \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Telefoni: \_\_\_\_\_

Modeli: \_\_\_\_\_

Numri serial: \_\_\_\_\_

Bateritë zëvendësuese

☐ Madhësia 10A

☐ Madhësia 312

Garancia: \_\_\_\_\_

Programi 1 është për: \_\_\_\_\_

Programi 2 është për: \_\_\_\_\_


Programi 3 është për: \_\_\_\_\_

Programi 4 është për: \_\_\_\_\_


Data e blerjes: \_\_\_\_\_

## Referencë e shpejtë


### Paralajmërimi për rënien e baterisë



### Përmasat e baterisë




### Ndezja/fikja



### Ndërrimi i baterive



### Butoni për shtypje



### Butoni i rrumbullakët



# Pasqyra e lëndës

|                                                             |    |
|-------------------------------------------------------------|----|
| Aparati juaj i dëgjimit me një shikim të shpejtë.....       | 2  |
| Paralajmërime.....                                          | 4  |
| Vendosja e aparatit të dëgjimit në veshë.....               | 14 |
| Ndezja dhe fikja e aparatit.....                            | 16 |
| Informacioni i baterisë.....                                | 17 |
| Tinnitus Masker.....                                        | 20 |
| Udhëzimet e përdorimit.....                                 | 23 |
| Përdorimi i telefonit .....                                 | 28 |
| Modaliteti i fluturimit (vetëm jazz XC Pro 312 Dir W) ..... | 37 |
| Aksesorët (vetëm jazz XC Pro 312 Dir W) .....               | 39 |
| Telekomanda IIC (vetëm aparatet e dëgjimit IIC) .....       | 41 |
| Mirëmbajtja e aparatit të dëgjimit .....                    | 43 |
| Pastrimi i aparatit të dëgjimit .....                       | 44 |
| Pajisjet ndihmëse të dëgjimit .....                         | 46 |
| Manuali i problemeve .....                                  | 47 |
| Informacion dhe shpjegimi i simboleve .....                 | 52 |
| Informacionet për përputhshmërinë .....                     | 55 |
| Vërejtjet tuaja.....                                        | 59 |
| Shënime të mëtejshme .....                                  | 60 |




## Aparati juaj i dëgjimit me një shikim të shpejtë

---


- 1 Mikrofoli - tingulli hyn në aparatet e dëgjimit nëpërmjet mikrofonave. Mbrojtësi i mikrofonit - mbron mikrofonin nga pluhuri dhe copat
- 2 Butoni me shtypje - bën ndërrimin e programeve të dëgjimit ose ndryshon nivelin e zërit, në varësi të përshtatjes
- 3 Dera e baterisë (aktive dhe joaktive) - mbyllni derën për të aktivizuar aparatet e dëgjimit, hapeni derën deri në fund për ta çaktivizuar aparatin e dëgjimit ose për të ndërruar baterinë
- 4 Butoni i rrumbullakët - kontrollon volumnin
- 5 Grila - ndihmon në zvogëlimin e pengesës që bërë që zëri juaj të tingëllojë më mirë
- 6 Doreza e heqjes - ndihmon për të hequr aparatet shumë të vogla nga kanali i veshit




☐ Kasa e plotë/kasa gjysmë/me drejtimin e kanalit




☐ Kasa gjysmë/me drejtim në kanal



☐ Minimale me drejtim në kanal



☐ CIC (plotësisht brenda në kanal) ☐ IIC (e padukshme në kanal)



## Paralajmërimi

- ⚠ Nuk lejohen ndryshimet apo modifikimet e këtij aparati dëgjimi pa miratimin e shprehur të prodhuesit. Ndryshime të tilla mund t'ju dëmtojnë veshët ose aparatin e dëgjimit.
- ⚠ Aparati i dëgjimit synohet për përdorim në amplifikimin dhe përçimin e zërit drejt veshëve, duke kompensuar kështu për problemet e dëgjimit. Aparati i dëgjimit (sidomos i programuar për humbje të tillë të dëgjimit) duhet të përdoret vetëm nga personi i synuar. Aparati nuk duhet të përdoret nga askush tjetër, pasi përndryshe mund t'u dëmtohet dëgjimi.
- ⚠ Aparati i dëgjimit duhet të përdoret vetëm sipas udhëzimeve të mjekut të përgjithshëm ose të specialistit audiolog.
- ⚠ Aparati i dëgjimit nuk e rikthen dëgjimin normal dhe nuk parandalon apo përmirëson problemet e dëgjimit që vijnë nga shkaqe organike.
- ⚠ Mos e përdorni aparatin e dëgjimit në zona me rrezik shpërthimi.





- ⚠ Nuk pritet të ketë reaksione alergjike ndaj aparatit të dëgjimit. Por, nëse keni kruajtje, skuqje, pezmatim, inflamacion apo ndjesi djegieje brenda apo përreth veshëve, vini në dijeni specialistin audiolog dhe kontaktoni me mjekun e përgjithshëm.
- ⚠ Në rastet tepër të rralla që ndonjë pjesë e aparateve të dëgjimit mbetet në kanalet e veshëve pas heqjes së aparatit, kontaktoni menjëherë me mjekun.
- ⚠ Programet e dëgjimit në modalitetin e mikrofonit të drejtuar pakësojnë zhurmën e sfondit. Kini parasysh se sinjalet apo zhurmat paralajmëruese që vijnë nga pas, p.sh. automjetet, mbyten pjesërisht ose tërësisht.
- ⚠ Ky aparat dëgjimi nuk është për foshnja nën 36-muajshe. Përdorimi i kësaj pajisjeje nga fëmijët dhe personat me probleme konjitive duhet të kryhet nën mbikëqyrje të vazhduar, për t'u garantuar sigurinë. Aparati i dëgjimit është pajisje e vogël dhe përmban pjesë të vogla. Mos ua lini pa mbikëqyrje këtë aparat dëgjimi fëmijëve dhe personave me probleme konjitive. Në rast gëlltitjeje, konsultohuni





menjëherë me mjekun apo spitalin, pasi aparati i dëgjimit apo pjesët e tij mund të shkaktojnë mbytje.

⚠ Mos bëni lidhje me tel nga aparati i dëgjimit me burime të jashtme zëri, si p.sh. radio etj. Mund të pësoni lëndime në trup (elektroshok).

⚠ Informacioni i mëposhtëm vlen vetëm për personat me pajisje të implantueshme aktive mjekësore (p.sh. stimulues kardiakë, defibrilatorë etj.):

- Mbajeni aparatin e dëgjimit me valë së paku 15 cm (6 in) larg implantit aktiv.

- Nëse vëreni ndonjë interferencë, mos e përdorni aparatin e dëgjimit me valë dhe kontaktoni me prodhuesin e implantit aktiv. Kini parasysh se interferenca mund të shkaktohet dhe nga linjat elektrike, shkarkesat elektrostатike, detektorët e metaleve në aeroporte etj.

⚠ Ekzaminimet e posaçme mjekësore apo dentare, ku përfshihet rrezatimi i përshkruar më poshtë, mund të cenojnë funksionimin normal të aparatit të dëgjimit. Hiqni dhe mbajini jashtë sallës/zonës së ekzaminimit përpara se të kryeni:





- Ekzaminimi mjekësor ose dentar me rreze rëntgen (si dhe skaner CT).
- Ekzaminime mjekësore me skaner MRI/NMRI, ku krijohen fusha magnetike.
- Aparati i dëgjimit nuk ka nevojë të hiqet kur kaloni në portat e sigurisë (p.sh. aeroporte etj.). Nëse përdoren rreze rëntgen në çfarëdo rasti, ato do të jenë në doza shumë të vogla dhe nuk ndikojnë në aparatin e dëgjimit.

⚠ Përdorimi i kësaj pajisjeje pranë apo përmbi pajisje të tjera duhet evituar, pasi mund të sjellë keqfunksionim. Nëse ju duhet ta përdorni në mënyrë të tillë, kjo pajisje dhe pajisjet e tjera duhet të mbikëqyren për të verifikuar nëse punojnë në rregull.

⚠ Përdorimi i aksesorëve, konvertuesve dhe kablllove të tjera nga ato të përcaktuara apo të dhëna nga prodhuesi i kësaj pajisjeje mund të shkaktojnë rritje të emetimeve elektromagnetike ose rënie të imunitetit elektromagnetik të pajisjes duke sjellë funksionim të papërshtatshëm.





- ⚠ Duhet bërë kujdes i veçantë gjatë mbajtjes së aparatit të dëgjimit kur nivelet maksimale të trysnisë zanore tejkalojnë 132 decibelët. Mund të ketë rrezik të dëmtoni dhe pjesën e mbetur të dëgjimit tuaj. Diskutojeni me mjekun tuaj për t'u siguruar që nivelin maksimal i aparatit tuaj të dëgjimit është i përshtatshëm për rastin tuaj të problemit në dëgjim.

#### Paralajmërimet e baterisë.

- ⚠ Asnjëherë mos i lini aparatet ose bateritë aty ku fëmijët dhe kafshët shtëpiake të kenë qasje. Mos e vendosni kurrë në gojë aparatin e dëgjimit apo bateritë. Nëse ndodh ta gëlltisni aparatin e dëgjimit apo baterinë, thërrisni menjëherë mjekun.





## Paralajmërimet specifike për modelin jazz XC Pro 312 Dir W:

- ⚠ Aparati juaj i dëgjimit funksionon në diapazon frekuencash 2,4–2,48 GHz. Kur jeni në fluturim, kontrolloni nëse operatori i fluturimit kërkon që pajisjet të caktohen në modalitetin e fluturimit.
- ⚠ Pajisjet portative të komunikimit me radiofrekuenca (duke përfshirë pajisjet periferike si p.sh. kabllot e antenave dhe antenat e jashtme) duhet të përdoren së paku 30 cm (12 in) larg aparatit të dëgjimit, duke përfshirë kabllot e rekomanduara nga prodhuesi. Përndryshe mund të ketë rënie efikasiteti të pajisjes.





## Masat paraprake

- ① Përdorimi i aparatit të dëgjimit është vetëm një pjesë e rehabilitimit dëgjimor; mund të nevojitet gjithashtu edhe trajnim dëgjimor, si dhe udhëzime për leximin e buzëve.
- ① Në shumicën e rasteve, përdorimi sporadik i aparateve nuk ju ofron përfitimet e plota. Pasi të jeni ambientuar me aparatën e dëgjimit, mbajeni në vesh çdo ditë gjatë gjithë ditës.
- ① Aparatet tuaja përdorin përbërësit më modern për të ju ofruar kualitetin e zërit më të mirë të mundshëm në çdo situatë dëgjimi. Megjithatë, pajisjet komunikuese siç janë telefonat celular mund të krijojnë ndërhyrje (tingull gumëzhim) në aparate. Nëse hasni në ndërhyrje të aparatit nga celularët që përdoren pranë jush, mund të minimizohen ndërhyrjen në mënyra të ndryshme. Fikni aparatet tuaja në një program tjetër, ktheni kokën në një drejtim tjetër ose lokalizoni se ku gjendet celulari dhe largohuni nga ai.





## Etiketimi

Numri i serisë dhe viti i prodhimit ndodhen në pjesën e jashtme të aparatit të dëgjimit.





## Vlera nominale e pajtueshmërisë me celularët

Disa përdorues të aparateve të dëgjimit kanë raportuar një gumëzhitje në aparatet e tyre të dëgjimit kur përdorin celularë, që tregojnë se celulari dhe aparatet e dëgjimit mund të mos jenë në përputhje me njëri-tjetrin. Në përputhje me standardin ANSI C63.19 (Metodat e matjes së përputhshmërisë midis pajisjeve të komunikimit me valë dhe aparateve të dëgjimit, sipas standardit kombëtar amerikan ANSI C63.19-2006), pajtueshmëria e një aparati të caktuar dëgjimi dhe e një celulari mund të parashikohet duke i shtuar vlerën nominale të imunitetit të aparatit të dëgjimit vlerës nominale për emetimet e celularit. Për shembull, shuma e vlerës nominale 4 (M<sub>4</sub>) të aparatit të dëgjimit me një vlerë nominale 3 (M<sub>3</sub>) të celularit do të jepnin një vlerë të kombinuar nominale 7. Çfarëdo vlere e kombinuar nominale baras me së paku 5 do të përbënte "përdorim normal"; një vlerë e kombinuar nominale 6 e lart do të përbënte "performancë optimale".

Imuniteti i këtij aparati dëgjimi është të paktën M<sub>4</sub>/T<sub>4</sub>.<sup>\*</sup> Matjet e rendimentit të pajisjes, kategoritë dhe klasifikimet e sistemit bazohen mbi informacionin më të mirë të mundshëm, por nuk garantojnë dot që do të përmbushen kërkesat e të gjithë përdoruesve.

<sup>\*</sup> Për modelet që përfshijnë një opsion të hyrjes me spirale







- ① Performanca e aparatit individual të dëgjimit mund të ndryshojë me telefonat celularë individualë. Për këtë arsye, provojeni këtë aparat dëgjimi me telefonin tuaj celular ose, nëse po blini një telefon të ri, sigurohuni ta provoni me aparatin tuaj të dëgjimit para se ta blini.








## Vendosja e aparatit të dëgjimit në veshë

Aparatet e dëgjimit mund të jenë me kode me ngjyra në kapakun e baterisë dhe/ose në etiketën në aparatin e dëgjimit: e kuqe = veshi i djathtë; blu = veshi i majtë.

### Futja e aparatit të dëgjimit



1. Mbajeni aparatin e dëgjimit mes gishtit të madh dhe gishtit tregues me kapakun e baterisë të drejtuar larg veshit.
2. Nëse aparati juaj i dëgjimit ka një dorezë për heqjen, futeni duke e mbajtur aparatin e dëgjimit me dorezën e heqjes në pjesën e poshtme.
3. Futni me kujdes pjesën e kanalit në vesh duke përdorur gishtin tregues për ta shtyrë dhe futur aparatin e dëgjimit plotësisht në vendin përkatës. Ai duhet të përshtatet mirë dhe lehtë. Tërhiqni me kujdes bulën e veshit poshtë dhe prapa për t'ju ndihmuar ta futni me më shumë lehtësi aparatin e dëgjimit në kanalin e veshit.





## Heqja e aparatit të dëgjimit

1. Për ta hequr aparatin e dëgjimit, kapeni atë me gishtin e madh dhe gishtin tregues. Nëse aparati juaj i dëgjimit ka një dorezë për heqjen, tërhiqeni lehtë për ta hequr aparatin tuaj të dëgjimit.
2. Lëvizieni nofullën lart dhe poshtë ose ushtroni trysni në pjesën e pasme të veshit për të ndihmuar për ta liruar aparatin tuaj të dëgjimit.



- ⓘ Mos i përdorni kontrollet ose kapakun e baterisë për të hequr aparatet e dëgjimit.




## Ndezja dhe fikja e aparatit.


Kapaku i baterisë vepron si çelës ndezjeje dhe fikjeje.

1. Ndezja: Mbylleni plotësisht kapakun e baterisë.

① Kur të ndizni aparatit tuaj të dëgjimit për herë të parë, funksionaliteti i butonit me shtypje mund të ketë një vonesë para se të bëhet aktiv për të parandaluar shtypjen aksidentale gjatë futjes



2. Fikja: Hapni kapakun e baterisë për ta fikur aparatit e dëgjimit dhe për të ndërruar baterinë.





## Informacioni i baterisë

---



### Paralajmërimi për rënien e baterisë

Dy tinguj të gjatë "bip" tregojnë se bateria e aparatit të dëgjimit është në nivel të ulët. Pas paralajmërimit për rënien e baterisë, zërat mund të mos jenë aq të qartë sa më parë. Kjo është normale dhe mund të ndreqet duke ndërruar bateritë.

Nëse nuk e dëgjoni paralajmërimin për rënien e baterisë, specialisti audiolog mund të ndryshojë frekuencën ose volumin. Nëse dëshironi, mund dhe ta fikni fare.

- ① Aparati juaj është i dizajnuar për të paralajmëruar dobësim të baterisë çdo 30 minuta derisa t'i ndërroni ato, por varësisht nga kualiteti i baterive, mund të ndalen para se të ndodh paralajmërimi. Ndaj dhe rekomandohet që bateria të ndërrohet sa më shpejt të jetë e mundur pasi të keni dëgjuar paralajmërimin për rënien e baterisë.

## Ndërrimi i baterisë



1. Nxirreni lehtë kapakun e baterisë me anë të thoit.
  2. Kapni baterinë me gishtin e madh dhe tregues dhe hiqeni.
  3. Futeni baterinë e re në ndarjen e baterisë me shenjën plus (+) në bateri të kthyer në të njëjtin drejtim me treguesin e baterisë në kapakun e baterisë. Kjo siguron që kapaku i baterisë të mbyllet siç duhet.
- ❗ Nëse bateria vendoset jokorrekt, aparati nuk ndizet.
4. Mbyllni kapakun e baterisë.



## Mirëmbajtja e baterive

- Bateritë hidhini gjithnjë në mënyrë të sigurt dhe ekologjike.
- Për të zgjatur jetën e baterisë, mos harroni ta fikni aparatin e dëgjimit nëse nuk ju duhet ta përdorni, sidomos gjatë gjumit.
- Hiqini bateritë dhe mbajeni kapakun e baterisë të hapur kur nuk e keni aparatin në vesh, sidomos gjatë gjumit. Kjo lejon avullimin e lagështisë së brendshme.





## Tinnitus Masker

"Tinnitus Masker" përdor zhurmë me brez të gjerë për të dhënë një qetësim të përkohshëm nga tinitusi.

### Paralajmërime për "Tinnitus Masker"

- ⚠️ "Tinnitus Masker" është një zhurmues me brez të gjerë. Ai bën të mundur terapinë me pasurim tingujsh që mund të përdoret si pjesë e një programi të personalizuar për menaxhimin e tinitusit (zhurmës në veshë), për të ofruar qetësim nga tinitusi.
- ⚠️ Parimi bazë i pasurimit të tingujve është dhënia e stimulimit shtesë me zhurmë, çka mund të ndihmojë në shpëputjen e vëmendjes suaj nga tinitusi duke evituar kështu reagimet negative. Pasurimi i tingujve, së bashku me konsultat udhëzuese, është një qasje funksionale tashmë për menaxhimin e tinitusit.
- ⚠️ Aparatet e dëgjimit me përcjim me ajër me "Tinnitus Masker" duhen vendosur nga një specialist audiolog i familjarizuar me diagnostikimin dhe menaxhimin e zhurmës në vesh.







- ⚠ Nëse ju shfaqen efekte anësore gjatë përdorimit të "Tinnitus Masker", si p.sh. dhimbje koke, të vjella, marramendje ose palpitacione kardiake, apo vëreni rënie të funksionit dëgjimor si p.sh. rënie të tolerancës ndaj zërit të lartë, përkeqësim të tinitusit ose të folurit nuk është më aq i qartë, duhet ta ndërprisni përdorimin e pajisjes dhe të kërkonj kujdesin mjekësor.
- ⚠ Volumi i "Tinnitus Masker" mund të caktohet në një nivel që mund dhe të shpjerë drejt dëmtimit të përhershëm të dëgjimit kur përdoret për një kohë të gjatë. Nëse "Tinnitus Masker" është caktuar në nivel të tillë në aparatën tuaj të dëgjimit, specialisti audiolog do t'ju këshillojë për kohëzgjatjen maksimale gjatë ditës kur mund ta përdorni "Tinnitus Masker". "Tinnitus Masker" nuk duhet të përdoret kurrë në nivele jokomode.





## Informacion i rëndësishëm

- ① "Tinnitus masker" krijon tinguj që mund të përdoren si pjesë e një programi të personalizuar për menaxhimin e përkohshëm të tinitusit, për të ofruar qetësim nga tinitusi. Duhet përdorur gjithnjë sipas rekomandimit nga një specialist audiolog i familjarizuar me diagnostikimin dhe trajtimin e zhurmës në vesh.
- ① Praktika e mirë shëndetësore kërkon që personi që raporton për tinitus të marrë një vlerësim mjekësor nga specialisti audiolog i licencuar përpara se të përdorë një pajisje zhurmëkrijuese. Qëllimi i një vlerësimi të tillë është të sigurojë që sëmundjet e trajtueshme nga ana mjekësore, të cilat mund të shkaktojnë tinitusin, të identifikohen dhe të trajtohen përpara përdorimit të pajisjes zhurmëkrijuese.
- ① "Tinnitus Masker" është planifikuar për të rriturit e moshës 18 vjeç e lart që kanë edhe humbje të dëgjimit, edhe tinitus.





## Udhëzimet e përdorimit

Aparatet tuaja të dëgjimit mund të vijnë me dy kontrolle që ju lejojnë t'i rregulloni ato më tej - një buton i rrumbullakët dhe një buton me shtypje.

Nëse aparatet e dëgjimit janë të modelit jazz XC Pro 312 Dir W, mund të përdorni po ashtu telekomandën opsionale Remote Control ose aplikacionin "Stream remote" për të kontrolluar aparatet e dëgjimit.

### Butoni i rrumbullakët



Butoni i rrumbullakët në aparatet tuaja të dëgjimit mund të konfigurohet si një kontroll volumi.

#### ☐ Kontrolli i volumit

Nëse butoni i rrumbullakët është konfiguruar si kontroll volumi:

- Rrotullojeni butonin ngadalë përpara drejt hundës suaj për të rritur volumin
- Rrotullojeni butonin ngadalë prapa larg hundës suaj për të ulur volumin




Nëse aparatet e dëgjimit janë të modelit jazz XC Pro 312 Dir W, një telekomandë opsionale Remote Control ju lejon po ashtu t'i rregulloni nivelet e volumit; referojuni udhëzuesit të përdorimit të Remote Control për më shumë informacione.

Gjatë ndërrimit të nivelit të zërit, aparati krijon tingull.

| Vendosja e volumit | Tingujt "bip"                                                                                    |
|--------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Volumi i sugjeruar |  1 bip          |
| Ngritja e volumit  |  bip i shkurtër |
| Ulja e volumit     |  bip i shkurtër |
| Volumi maksimal    |  2 bipe         |
| Volumi minimal     |  2 bipe         |



## Butoni për shtypje



Butoni me shtypje në aparatit e dëgjimit mund të jetë një kontroll programi, një kontroll volumni ose një kombinim të të dyjave.

### ☐ Komanda e programeve

Nëse butoni me shtypje është konfiguruar si një kontroll programi, sa herë që të shtypni butonin do të kaloni në një program tjetër të aparatit të dëgjimit.

Aparati i dëgjimit lëshon një "bip" për të treguar se në cilin program jeni.

| Cilësimi i programit                                             | Tingujt "bip"                                             |
|------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|
| Programi 1 (p.sh. program automatik)                             | ♪ 1 bip                                                   |
| Programi 2 (p.sh. të folurit në zhurmë)                          | ♪♪ 2 bipe                                                 |
| Programi 3 (p.sh. telefoni/telefoni automatik)                   | ♪♪♪ 3 tinguj                                              |
| Programi 4 (p.sh. muzika)                                        | ♪♪♪♪ 4 tinguj                                             |
| Telefoni automatik (vetëm jazz XC 312 Omni dhe jazz XC 10A Omni) | ♪♪♪ Melodia e shkurtër                                    |
| BiLink (vetëm jazz XC W 312 Dir)                                 | Tingujt janë të njëjtë në të dy veshët gjatë përshtatjes. |

Shikoni kopertinën e kësaj broshure për një listë të programeve tuaja të personalizuar.



## □ Kontrolli i volumit

Nëse butoni me shtypje është konfiguruar si kontroll volumi:

- Shtypni butonin në aparatin e djathtë të dëgjimit për të rritur volumin, dhe
- Shtypni butonin në aparatin e majtë të dëgjimit për të ulur volumin

ose:

- Shtypni butonin për të kaluar nëpër nivelet e volumit

Kur ndërroni kontrollin e volumit, aparati i dëgjimit do të lëshojë sinjale bip.

| Vendosja e volumit | Tingujt "bip"    |
|--------------------|------------------|
| Volumi i sugjeruar | ♪ 1 bip          |
| Ngritja e volumit  | ♪ bip i shkurtër |
| Ulja e volumit     | ♪ bip i shkurtër |
| Volumi maksimal    | ♪♪ 2 bipe        |
| Volumi minimal     | ♪♪ 2 bipe        |





## BiLink

(vetëm jazz XC Pro 312 Dir W)

Kur të ndryshoni cilësimet e volumit ose të programit në një aparat dëgjimi, aparati tjetër do të ndryshohet po ashtu. BiLink funksionon për butonin me shtypje si dhe për butonin e rrumbullakët.

Për shembull, nëse butoni me shtypje është konfiguruar si kontroll programi, kur të shtypni butonin në një aparat dëgjimi, programi do të ndryshohet në të dyja aparatet.





## Përdorimi i telefonit

---

### ☐ Butoni për shtypje

Specialist audiolog mund të ketë konfiguruar një program telefoni në aparatin tuaj të dëgjimit që mund ta përdorni me butonin me shtypje. Nëse aparatet tuaja të dëgjimit janë të modelit jazz XC W 312 Dir, mund të keni akses te programi i telefonit edhe me telekomandën opsionale Remote Control.

Vetëm jazz XC Pro 312 dhe jazz XC Pro 10:

### ☐ PhoneConnect

Aparatet tuaja të dëgjimit mund të kenë një program telefoni, i cili e kalon automatikisht te një program i posaçëm i telefonit kur një marrës afrohet te një nga aparatet e dëgjimit. Do të dëgjoni një melodi të shkurtër kur të kaloni te programi i telefonit automatik. Kur marrësi largohet nga aparati i dëgjimit, ai kthehet automatikisht në programin e mëparshëm të dëgjimit.










Nëse aparati juaj i dëgjimit nuk kalon automatikisht te programi i telefonit automatik kur mbani një marrës afër veshit, mund të duhet të vendosni një magnet të telefonit automatik te telefoni. Magneti është projektuar për të forcuar fushën magnetike në formën e personalizuar të telefonit.

Për të vendosur magnetin opsional:


1. Pastroni marrësin e telefonit. Mbani magnetin afër "fundit dëgjues" të pranuesit telefonik dhe lëshojeni atë. Magneti do të rrotullohet në anën e duhur dhe të kërkojë pozicion në pranuesin e telefonit.
  2. Vendosni shiritin me dy anë në këtë pozicion optimal në marrësin e telefonit.
  3. Vendosni magnetin në shirit.
-  Specialisti juaj audiolog mund të ketë përgatitur po ashtu një program telefoni që mund ta përdorni nëpërmjet telekomandës opsionale.





## Çiftimi i telefonit celular me aparatet e dëgjimit jazz XC Pro 312 Dir W

1. Në celular, shkoni te menyja e cilësimeve për t'u siguruar që keni aktivizuar **Bluetooth®** dhe për të kërkuar për pajisje që mund të lidhen me "Bluetooth".
  2. Ndizeni aparatin e dëgjimit duke mbyllur kapakun e baterisë. Aparati juaj i dëgjimit do të qëndrojë në modalitet çiftimi për 3 minuta.
  3. Celulari do të nxjerrë një listë të pajisjeve të gjetura që mund të lidhen me "Bluetooth". Zgjidhni aparatin tuaj të dëgjimit nga lista dhe çiftojini njëherësh të dyja njësitë e aparatit. Do të dëgjoni një melodi pasi celulari të çiftohet me sukses me aparatin e dëgjimit.
- ❖ Procedurën e çiftimit mjafton ta kryeni vetëm një herë me çdo celular që lidhet me anë të "Bluetooth".
- ❖ Konsultohuni me manualin e celularit për udhëzime mbi çiftimin e tij me pajisje me "Bluetooth".



Bluetooth® është një markë tregtare e regjistruar në pronësi të Bluetooth SIG, Inc.



## Lidhja me celularin

Pasi ta keni çiftuar aparatin e dëgjimit me celularin, këta do të lidhen vetiu në vijim kur celulari dhe aparati i dëgjimit të jenë të ndezur dhe brenda rrezes. Kjo mund marrë deri në 2 minuta.


- ① Lidhja do të ruhet për sa kohë që telefoni qëndron i ndezur dhe brenda një rrezeje prej deri në 10 m (30 ft).
- ① Për të përcjellë telefonatën midis aparatit të dëgjimit dhe altoparantit të celularit, zgjidhni burimin e audios që dëshironi nga celulari. Nëse nuk jeni të sigurt se si ta kryeni veprimin, shihni manualin e përdorimit që keni marrë me celularin.



## Telefonatat me një celular dhe aparatet e dëgjimit jazz XC Pro 312 Dir W

Aparatet e dëgjimit jazz XC Pro 312 Dir W lejojnë komunikimin e drejtpërdrejtë me telefonat që kanë të aktivizuar funksionin Bluetooth. Kur është i çiftuar dhe i lidhur me një celular, do ta dëgjoni zërin e telefonuesit direkt në aparatin e dëgjimit. Aparati juaj i dëgjimit e merr zërin tuaj përmes mikrofonave të vet.

- i Nuk ka nevojë ta mbani celularin pranë gojës, zëri juaj përcillet nga aparati i dëgjimit drejt celularit.





## Përdorimi i telefonit celular me aparatet e dëgjimit jazz XC Pro 312 Dir W



### Kryerja e telefonatave

Niseni telefonatën në celularin e çiftuar siç do ta bënit normalisht. Audion do ta dëgjoni përmes aparatit të dëgjimit. Aparati juaj i dëgjimit e merr zërin tuaj përmes mikrofonave të vet.

### Marrja e telefonatave të celularit

Kur merrni një telefonatë, do të dëgjoni njoftimit e mbërritjes së telefonatës në aparatin e dëgjimit.

Telefonata mund të pranohet me një shtypje të shkurtër për më pak se 2 sekonda në butonin me shtypje në një nga aparatet e dëgjimit. Përndryshe, pranojeni telefonatën në celular si normalisht.



shtypje e  
shkurtër  
nën 2 sek





## Mbyllja e telefonatave

Mbylleni telefonatën duke e mbajtur të shtypur butonin me shtypje në një nga aparatet e dëgjimit për më shumë se 2 sekonda. Përndryshe, mbylleni telefonatën në celular si normalisht.

## Refuzimi i telefonatave

Një telefonatë hyrëse mund ta refuzoni duke mbajtur të shtypur për më shumë se 2 sekonda butonin me shtypje në një nga aparatet e dëgjimit. Përndryshe, refuzojeni telefonatën në celular si normalisht.



shtypje e  
gjatë  
mbi 2 sek





## Tinnitus Masker

---

Nëse specialisti audiolog ka konfiguruar një program "Tinnitus Masker" dhe një kontroll volumi, mund ta ndryshoni nivelin e "Tinnitus masker" kur të ndodheni në programin "Tinnitus Masker". Për të rregulluar nivelin e zhurmës:

- ☐ Butoni i rrumbullakët
  - Rrotullojeni butonin ngadalë përpara drejt hundës suaj për të rritur "tinnitus masker" dhe
  - Rrotullojeni butonin ngadalë prapa larg hundës suaj për të ulur "tinnitus masker"
- ☐ Butoni me shtypje (djathtas/majtas)
  - Shtypni butonin në aparatin e djathtë të dëgjimit për të rritur "tinnitus masker", dhe
  - Shtypni butonin në aparatin e majtë të dëgjimit për të ulur "tinnitus masker"
- ☐ Butoni me shtypje (hapat)
  - Shtypni butonin për të kaluar nëpër nivelet e "tinnitus masker"



vetëm jazz XC Pro 312 Dir W:

Aplikacioni "Stream remote":

- Prekni shigjetën për të kaluar në ekranin e dytë ku mund të rrisni apo ulni volumin e "Tinnitus Masker"

Kur ndryshoni nivelin, aparati i dëgjimit jep një tingull "bip".









## Modaliteti i fluturimit (vetëm jazz XC Pro 312 Dir W)

Aparati juaj i dëgjimit funksionon në diapazon frekuencash 2,4–2,48 GHz. Kur jeni në fluturim, disa linja ajrore kërkojnë që të gjitha pajisjet të caktohen në modalitetin e fluturimit. Vendosja në modalitet fluturimi nuk e çaktivizon funksionin normal të aparatit të dëgjimit, por vetëm funksionet e lidhjes me "Bluetooth".

### Aktivizimi i modalitetit të fluturimit

Për të çaktivizuar funksionin e lidhjes me valë "Bluetooth" dhe vendosjen e modalitetit të fluturimit:

1. Hapni kapakun e baterisë.
2. Kur aparati i dëgjimit është i fikur, mbani të shtypur butonin me shtypje në aparatit e dëgjimit ndërkohë që mbyllni kapakun e baterisë dhe mbajeni butonin të shtypur për 7 sekonda.







## Çaktivizimi i modalitetit të fluturimit

Për të aktivizuar funksionin e lidhjes me valë "Bluetooth" dhe daljen nga modaliteti i fluturimit:

1. Hapni kapakun e baterisë.
2. Mbyllni kapakun e baterisë.





## Aksesorët

(vetëm jazz XC Pro 31 2 Dir W)

---

Aksesorët e mëposhtëm janë të përputhshëm me aparatet e dëgjimit jazz XC W 312 Dir:

### TV Connector

TV Connector është një aksesori optik që e dërgon zërin e televizorit direkt tek aparati i dëgjimit. TV Connector mund të përcjellë dhe zërin e sistemeve stereo, kompjuterëve dhe burimeve të tjera zanore.

### Remote Control

Telekomanda Remote Control është një aksesori opsional që mund të përdoret për të kontrolluar nivelin e volumit dhe ndryshimet e programit në aparatin e dëgjimit.

### PartnerMic

PartnerMic është një aksesori opsional që mund të përdoret për të transmetuar zërin e personit që flet me anë të valëve tek aparati juaj i dëgjimit.



## RogerDirect™

Aparati juaj i dëgjimit është në përputhje me aksesorët Roger™. Aksesorët Roger mund të përdoren për të transmetuar një zë ose burim zëri me anë të valëve tek aparati juaj i dëgjimit.

Për më shumë informacione, shikoni udhëzuesin e përdorimit që vjen me aksesorin tuaj. Kontaktoni me specialistin audiolog për të marrë një TV Connector, Remote Control, PartnerMic, telekomandën IIC ose aksesorë Roger.



## Telekomanda IIC (vetëm aparatet e dëgjimit IIC)

- ⚠ Telekomanda IIC përfshin një magnet. Nëse përdorni një pajisje mjekësore si stimulues kardiak ose pajisje ICD (defibrilator kardioverter të implatueshëm), lexoni udhëzuesin specifik të përdorimit për të sqaruar ndikimin e mundshëm të fushave magnetike te pajisja juaj mjekësore.
- ⚠ Mos e vendosni telekomandën IIC (të hapur ose të mbyllur) në xhepin e kraharorit. Mbani një distancë të paktën 15 cm (6 inç) mes telekomandës IIC dhe pajisjes mjekësore.

Telekomanda IIC përfshin një magnet që funksionon si telekomandë për ndryshimin e parametrave të aparateve tuaja të dëgjimit.






Aparatet tuaja të dëgjimit, në kombinim me telekomandën IIC, mund të konfigurohen si:

- ☐ Çelësi i ndërrimit të programit
- ☐ Kontrolli i volumit

Për të përdorur telekomandën IIC, zhvidhoseni magnetin nga kasa e varësës dhe mbajeni në kanalin e veshit pa e prekur aparatit e dëgjimit.





## Mirëmbajtja e aparatit të dëgjimit

---

- Hap kapakun e baterisë kur nuk është në përdorim.
- Hiqeni gjithnjë aparatin e dëgjimit kur përdorni artikuj për flokët. Aparati i dëgjimit mund të bllokohet dhe të pushojë së funksionuari siç duhet.
- Mos e mbani aparatin e dëgjimit në banjë apo në dush, dhe mos e zhysni në ujë.
- Nëse aparati i dëgjimit laget, mos u përpiqni ta thani në furrë apo në mikrovalë. Mos ia ndryshoni komandat. Hapni kapakun e baterive menjëherë, dhe lejoni që aparatet të thahen në mënyrë natyrale për 24 orë.
- Mbrojeni aparatin e dëgjimit nga nxehtësia e tepërt (p.sh. tharëse flokësh, xhep apo kruskot automjeti).
- Përdorimi i rregullt i një larguesi lagështire si p.sh. kompleti Dri-Aid, mund të ndihmojë në parandalimin e ndryshkut dhe zgjatjen e jetës së aparatit të dëgjimit.
- Mos e rrëzoni aparatin e dëgjimit dhe mos e përplasni në sipërfaqe të forta.



## Pastrimi i aparatit të dëgjimit

Përdorni në leckë të butë për pastrimin e aparatit të dëgjimit në fund të çdo dite. Pastrimi i rregullt i foleve të mikrofonit me furçën e dhënë të pastrimit do të sigurojë ruajtjen e cilësisë së zërit të aparatit. Specialisti audiolog mund t'ju tregojë se si ta bëni diçka të tillë.

Vendoseni aparatin e dëgjimit në kuti gjatë natës me kapakun e baterisë të hapur, për të lejuar avullimin e lagështirës.

- ① Dylli i veshëve është i natyrshëm dhe i zakonshëm. Kujdesi që ta mbani aparatin e dëgjimit pa dyllë veshës është një hap i rëndësishëm në rutinën tuaj ditore të pastrim-mirëmbajtjes.
- ① Duke përdorur furçën që keni marrë me aparatet tuaja të dëgjimit, pastroni dyllin e veshit nga aparatet tuaja të dëgjimit çdo ditë.
- ① Mos përdorni kurrë alkool për pastrimin e aparateve të dëgjimit.







- ① Mos përdorni mjete të mprehta për heqjen e dyllit të veshëve. Futja e sendeve shtëpiake në aparatet tuaja të dëgjimit mund t'i dëmtojë ato rëndë.
- ① Flisni me specialistin tuaj audiolog për takimet e zakonshme për heqjen e dyllit nga aparatet tuaja të dëgjimit.





## Pajisjet ndihmëse të dëgjimit

---

### Dëgjimi në vende publike

Tubat spirale kapin energji elektromagnetike duke e konvertuar në zë. Aparatet e dëgjimit mund të kenë opsionin e tubit spiral që mund t'ju ndihmojë të dëgjoni në vende publike të pajisura me pajisjet ndihmëse të dëgjimit me ndihmën e tubave spiralë si p.sh. sistemi i dëgjimit të hapur. Kur shikoni këtë simbol, një sistem dëgjimi i hapur është i pranishëm dhe ai mund të jetë i përputhshëm me aparatin tuaj të dëgjimit. Ju lutemi kontaktoni personin përgjegjës për më shumë informacione në sistemin e hapur të dëgjimit.





## Manuali i problemeve

| Shkaku                                          | Masa e mundshme                                                                                  |
|-------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Problemi: Nuk ka zë                             |                                                                                                  |
| Nuk është ndezur                                | Ndizeni                                                                                          |
| Ka rënë/mbaruar bateria                         | Ndërroni baterinë                                                                                |
| Kontakt i dobët i baterisë                      | Këshillohuni me personin përgjegjës të baterive tuaja                                            |
| Bateria përmbys                                 | Futni baterinë me shenjën (+) me fytyrë lartë                                                    |
| Aparatet e dëgjimit të bllokuara me dyllë veshi | Shikoni "Pastrimi i aparatit të dëgjimit". Këshillohuni me personin përgjegjës të baterive tuaja |





Shkaku

Masa e mundshme

Problemi: Nuk dëgjohej mjaftueshëm

Volum i ulët

Rritni volumin; kontaktoni me specialistin audiolog për modelet pa kontroll manual të volumit ose nëse problemi vazhdon

Ka rënë bateria

Ndërroni baterinë

Aparatet e dëgjimit nuk janë futur si duhet

Shikoni "Vendosja e aparateve të dëgjimit në veshë". Hiqeni dhe rivendoseni siç duhet

Ndryshim në dëgjim

Këshillohuni me personin përgjegjës të baterive tuaja

Aparatet e dëgjimit të bllokuara me dyllë veshi

Shihni "Pastrimi i aparatit të dëgjimit". Këshillohuni me personin përgjegjës të baterive tuaja





## Shkaku

## Masa e mundshme

Problemi: E përhershme

Ka rënë bateria

Ndërroni baterinë

Kontakti baterisë ka  
papastërti

Këshillohuni me personin  
përgjegjës të baterive tuaja

Problemi: Dy tinguj të gjatë "bip"

Ka rënë bateria

Ndërroni baterinë

Problemi: Fishkëllima

Aparatet e dëgjimit nuk  
janë futur si duhet

Shikoni "Vendosja e  
aparateve të dëgjimit  
në veshë". Hiqeni dhe  
rivendoseni siç duhet

Ka dorë/veshje pranë  
veshit

Largoni dorën/rrobat nga  
veshi juaj

Aparatet e dëgjimit janë  
vendosur gabim

Këshillohuni me personin  
përgjegjës të baterive tuaja



**Shkaku**

**Masa e mundshme**

**Problemi: Paqartësi, shtrembërim**

Aparatet e dëgjimit janë vendosur gabim

Këshillohuni me specialistin audiolog

Aparatet e dëgjimit të bllokuara me dyllë veshi

Shihni "Pastrimi i aparatit të dëgjimit". Këshillohuni me personin përgjegjës të baterive tuaja

Ka rënë bateria

Ndërroni baterinë

**Problemi: volum i ulët në telefonat fiks**

**Volum i ulët**

**Rritja e volumit**

Telefoni nuk mbahet siç duhet

Lëvizni pranuesin e telefonit rreth veshit për sinjal më të qartë. Shihni "Përdorimi i telefonit"

Aparati i dëgjimit ka nevojë për përshtatje

Këshillohuni me personin përgjegjës të baterive tuaja





## Shkak

## Masa e mundshme

Problemi: Telefonatat nuk dëgjohen nëpërmjet aparateve të dëgjimit (aparartet e dëgjimit jazz XC Pro 312 Dir W)

Aparati i dëgjimit është në modalitet fluturimi

Dilni nga modaliteti i fluturimit: hapni kapakun e baterisë, pastaj rimbylleni kapakun e baterisë

Aparartet e dëgjimit nuk janë çiftuar me telefonin

Çiftojini aparartet e dëgjimit me celularin (sërish)



Për ndonjë problem që nuk është i shkruar në udhëzues, kontaktoni me specialistin audiolog.





## Informacion dhe shpjegimi i simboleve



Me simbolin CE, Sonova AG konfirmon se ky produkt, duke përfshirë aksesoret, përmbush kërkesat e Direktivës për pajisjet mjekësore 93/42/KEE si dhe të Direktivës për radiopajisjet 2014/53/BE në lidhje me transmetuesit radio dhe të telekomunikacionit.

Numrat pas simbolit CE përkojnë me kodin e institucioneve të certifikuara që janë konsultuar sipas direktivave të lartpërmendura.



Ky simbol tregon se është e rëndësishme që përdoruesi të lexojë dhe të marrë parasysh informacionin përkatës në këtë udhëzues përdorimi.



Ky simbol tregon se është e rëndësishme që përdoruesi t'u kushtojë vëmendje deklaratave përkatëse paralajmëruese në këtë udhëzues përdorimi.



Informacion i rëndësishëm për administrimin dhe përdorimin efikas të produktit.



Ky simbol tregon se produktet e përshkruara në këto udhëzime përdorimi janë në pajtim me kërkesat për pjesë të aplikuara të tipit "B" të standardit EN 60601-1. Sipërfaqja e aparatit të dëgjimit përcaktohet si pjesë e aplikuar e tipit "B".



Simboli i të drejtave të autorit







Tregon përfaqësuesin e autorizuar në Komunitetin Evropian.



Ky simbol duhet të shoqërohet nga emri dhe adresa e prodhuesit (që e qarkullon këtë pajisje në treg).

## Kushtet e punës:

Kjo pajisje është krijuar në formë të atillë që të funksionojë pa probleme apo kufizime siç synohet, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këta udhëzues përdorimi.

## Kushtet e transportit:

Temperatura: Kufiri minimal =  $-20^{\circ}\text{C}$

( $-4^{\circ}\text{F}$ ), Kufiri maksimal =  $+60^{\circ}\text{C}$  ( $+140^{\circ}\text{F}$ )

Lagështira: Kufiri minimal = 0%, Kufiri maksimal = 70%

Presioni: Kufiri minimal = 50 kPa, Kufiri maksimal = 106 kPa



Simboli me koshin e mbivendosur me kryq përdoret për t'ju bërë me dije se kjo pajisje nuk duhet të hidhet si mbeturinat e zakonshme shtëpiake. Ju lutemi që të gjitha pajisjet a papërdorura të hedhen në vendin e caktuar vetëm për elektronikë, ose dorëzoni aparatin tuaj personit përgjegjës për hedhje. Hedhja e duhur mbron mjedisin dhe shëndetin.



**Bluetooth** Fjala e markës dhe logot e Bluetooth® janë marka tregtare të regjistruara në pronësi të Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i markave të tilla nga prodhuesi kryhet nën licencë. Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtarë janë sipas zotëruesve të tyre përkatës.



Data e prodhimit



Numri i serisë



Kufizimi i temperaturës për transportin dhe ruajtjen



Kufizimi i lagështisë për transportin dhe ruajtjen



Kufizimi i trysnisë atmosferike për transportin dhe ruajtjen



Mbajeni të thatë





# Informacionet për përputhshmërinë

## Deklarata e konformitetit

Sonova AG deklaron nëpërmjet këtij dokumenti se ky produkt përmbush kërkesat e Direktivës për pajisjet mjekësore 93/42/KEE dhe është në përputhje me Direktivën për radiopajisjet 2014/53/BE. Teksti i plotë i Deklaratave të konformitetit mund të merret nga prodhuesi nëpërmjet adresës së mëposhtme të internetit: <https://www.hansaton.de/en/declarations-of-conformity>

## Australi/Zelandë e Re:



**R-NZ**

Tregon pajtimin e një pajisjeje me përcaktimet rregullatore të Administratës së Radiospektrit (RSM) dhe të Autoritetit të Medias dhe Komunikimit të Australisë (ACMA) për shitje të ligjshme në Zelandën e Re dhe në Australi. Etiketa e pajtueshmërisë R-NZ është për radioproduktet e qarkulluara në tregun e Zelandës së Re sipas nivelit A1 të konformitetit.

Aparati i dëgjimit i përshkruar në këtë manual përdorimi është i certifikuar si:

Aparat standard dëgjimi

|                                  |                |              |
|----------------------------------|----------------|--------------|
|                                  | SHBA - FCC ID: | Kanada - IC: |
| jazz XC Pro 312 Dir W (djathtas) | KWC-INR        | 2262A-INR    |
| jazz XC Pro 312 Dir W (majtas)   | KWC-IND        | 2262A-IND    |

## Shënim 1

Kjo pajisje pajtohet me pjesën 15 të rregullave të FCC dhe me RSS-210 të "Industry Canada". Përdorimi u nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

- 1) kjo pajisje nuk duhet të shkaktojë interferencë të dëmshme; dhe
- 2) kjo pajisje duhet të pranojë çfarëdo interference të marrë, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë funksionim të padëshiruar.



## Njoftimi 2

Ndryshimet ose modifikimet të bëra në këtë pajisje që nuk janë miratuar shprehimisht nga Sonova AG mund ta bëjnë të pavlefshëm autorizimin e FCC-së për përdorimin e kësaj pajisjeje.

## Njoftimi 3

Kjo pajisje është testuar dhe ka rezultuar në pajtim me kufijtë për pajisje dixhitale të klasit "B", në përputhje me pjesën 15 të rregullores së FCC dhe ICES-003 të "Industry Canada". Këta kufij janë krijuar për të ofruar mbrojtje të arsyeshme kundrejt interferencave të dëmshme në instalime në ambiente banimi. Kjo pajisje krijon, përdor dhe mund të rrezatojë energji radiofrekuence dhe, nëse nuk instalohet e përdoret në përputhje me udhëzimet, mund të shkaktojë interferencë të dëmshme në radiokomunikime. Por nuk ka garanci se nuk do të ndodhë interferencë në instalime të caktuara. Nëse pajisja shkakton interferencë të dëmshme në marrjen e radios apo të televizorit, diçka që mund të përcaktohet duke e fikur dhe rindezur pajisjen, përdoruesit i sugjerohet të provojë ta zgjidhë interferencën me një a më shumë prej masave të mëposhtme:

- Riorientim apo ndryshim të vendit të antenës marrëse
- Rritje të distancës midis pajisjes dhe marrësit
- Lidhje të pajisjes në një prizë të një qarku tjetër nga ai ku është lidhur marrësi
- Konsultim për ndihmë me shitësin apo një teknik radioje/televizori me përvojë





### **Informacioni i radiolidhjes së aparatit të dëgjimit me valë**

|                   |                         |
|-------------------|-------------------------|
| Lloji i antenës   | Antenë me qark rezonant |
| Frekuenca e punës | 2,402–2,480 GHz         |
| Modulimi          | GFSK, Pi/4 DPSK         |
| Fuqia e rrezatuar | <1 mW (EIRP)            |

### **Bluetooth®**

|                         |                                             |
|-------------------------|---------------------------------------------|
| Rrezja                  | ~ 1 m (klasa 3)                             |
| Bluetooth               | Versioni 4.2                                |
| Profillet e mbështetura | HFP (profili i përdorimit pa duar),<br>A2DP |



### **Pajtimi me standardet e emetimit dhe të imunitetit**

|                       |               |
|-----------------------|---------------|
| Standardet e emetimit | EN 60601–1-2  |
|                       | IEC 60601–1-2 |
|                       | EN 55011      |
|                       | CISPR11/AMD1  |
|                       | CISPR22       |
|                       | CISPR32       |
|                       | ISO 7637-2    |
|                       | CISPR25       |
|                       | EN 55025      |





|                         |                        |
|-------------------------|------------------------|
| Standardet e imunitetit | EN 60601-1-2           |
|                         | IEC 60601-1-2          |
|                         | EN 61000-4-2           |
|                         | IEC 61000-4-2          |
|                         | EN 61000-4-3           |
|                         | IEC 61000-4-3          |
|                         | EN 61000-4-4           |
|                         | IEC 61000-4-4          |
|                         | EN 61000-4-5           |
|                         | IEC 61000-4-5          |
|                         | EN 61000-4-6           |
|                         | IEC 61000-4-6          |
|                         | EN 61000-4-8           |
|                         | IEC 61000-4-8          |
|                         | EN 61000-4-11          |
|                         | IEC 61000-4-11         |
|                         | IEC 60601-1 (§ 4.10.2) |
|                         | ISO 7637-2             |





## Vërejtjet tuaja

Regjistroni nevojat ose shqetësimet tuaja specifike dhe bëjini të ditura me vizitën e parë në zyrë pasi të keni marrë aparatet e dëgjimit.

Kjo ndihmon që specialisti audiolog t'ju japë zgjidhje për nevojat tuaja.

☐

---

---

☐

---

---

☐

---

---

☐

---

---

☐

---

---













Sonova AG  
Laubisrütistrasse 28  
CH-8712 Stäfa, Switzerland



Dhe importuesi për Bashkimin Evropian:  
Sonova Deutschland GmbH  
Max-Eyth-Str. 20  
70736 Fellbach-Oeffingen, Germany

[www.hansaton.com](http://www.hansaton.com)

CE  
0459





Distributor

2020-09 029-6437-90 © 2020 Sonova AG. All rights reserved.

